



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Bojan Mladenovic
Pronar
Privatno Preduzece "Herc"
TV Herc
Shtërpcë

Ref: 1408/962/KPM/II

VENDIM

për ndryshimin e frekuencës nga CH 35, për të kaluar me transmetim në CH 26

Fakte

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. TV Herc, me seli në Komunën e Shtërpcës, është pajisur me licencë afatgjate të KPM-së më datën 6 tetor 2009, për të vepruar si subjekt transmetues me kategori rajonale.
3. KPM, më datën 31 korrik 2014, ka pranuar kërkesën nga Rrjeti Tokësor Kosovar i Telekomunikimeve (KTTN), i autorizuar nga TV stacionet me transmetim nacional për të liruar frekuencat e koordinuara nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikimeve (ITU) të parapara për transmetim nga TV stacionet me mbulim nacional nga maja e Cërnushës.
4. Në ato frekuenca bën pjesë edhe kanali CH35 i cili shfrytëzohet nga maja e Piribregut për transmetim të programeve të TV Herc-it, në komunën e Shtërpcës.
5. Për të evituar çdo pengesë eventuale në frekuencat e përcaktuara sipas planit ndërkombëtar të ITU-së, është vlerësuar i domosdoshëm ndryshimi i frekuencës së subjektit transmetues TV Herc.

Arsyetim


6. Frekuenca për transmetim në kanalin CH 35, përveç kanaleve tjera, është e koordinuar ndërkombëtarisht për transmetim analog nga Maja e Cërushës, mirëpo, për shkak të situatës emergjente të periudhës së pasluftës, në vend të shfrytëzimit të kanalit CH 35 për transmetim analog nga njw TV stacion me mbulim nacional, është vendosur të shfrytëzohet kanali CH 44 (*kanal i koordinuar për transmetim nga Maja e Goleshit*), për një periudhë të përkohshme. Kjo, për arsye të pamundësisë së shfrytëzimit të Majës së Goleshit për transmetim, për shkak të vendosjes së forcave paqeruajtëse të NATO-s dhe ndalesave të tyre për të pas qasje në këtë pikë transmetimi.
7. Sipas marrëveshjes së GE06 për Transmetim Televiziv Digjital (TTD), kanali CH 44 për transmetim nga Maja e Goleshit është i koordinuar ndërkombëtarisht dhe i njëjti duhet të lirohet nga përdorimi për transmetim analog prej Majës së Cërnushës, për planifikim për shfrytëzim të TTD në Republikën e Kosovës sipas afateve të përcaktuara nga ITU dhe në pajtim me marrëveshjen GE 06.
8. Sipas rezultateve të majteve teknike nga Departamenti pwr Menaxhim Frekuencor, Komisioni konstaton se kanali CH 26 për transmetim të programeve të TV Herc nga pika e Piribregut është i lirë për t'u shfrytëzuar dhe nuk shkakton ndërhyrje në sinjalet tjera televizive që operojnë në Republikën e Kosovës.
9. Ky ndryshim bëhet në bazë të nenit 6.2 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së, që ka të bëjë me "Ndryshimet e KPM-së në licencë".

Vendim

10. Komisioni merr vendim për të ndryshuar frekuencën e TV Herc, duke kaluar transmetimin e programeve në kanalin CH 26.
11. Komisioni merr vendim që ky ndryshim i kanalit të bëhet në një afat prej 14 ditësh, nga marrja e vendimit.

Lëshimi i Vendimit

12. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit të tij.


Adnan MEROVCI
Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



16.09.2014
datë